



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 15 datë 15.04, 2022

**Për ndryshimin e vendimit nr 13, datë 25.02.2022 për ndryshim afati të marrjes me qira nga 9 (nëntë) dhe 10 vjeçar të sipërfaqes prej 1,9885 ha “Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje etj, si dhe për ndërtim restoranti në ngastrën nr.45 në ekonominë pyjore Gomsiqe”.**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës, të:

**V E N D O S I :**

1. Ndryshimin e vendimit nr 13, datë 25.02.2022 të dhënies në përdorim të ngastres nr. 45, Ekonomia Pyjore Gomsiqe me sipërfaqe prej 1,9885 ha **“Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje etj, si dhe për ndërtim restoranti”.**
2. **Afati i dhënies me qira të jetë 10 (dhjetë) vjet.**
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti, sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM nr. 1064, dt. 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

**KRYETARI**

**MARK BABANI**

**Konceptoi: Z.Ujka**

**Konceptoi Bazën Ligjore K.Shtatri**

**Miratoi: Rr.Ftoni**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**  
**Sektori i Menazhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 27 prot.

Vau Dejës, më 15.04 2022

**RELACION**

**Për ngryshim vendimit nr 13 datë 25.02.2022.**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjitnr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet“, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , **neni 54 pika el neni 18**, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 7.

**Për arsye të procedurës se metejshme të lejës se ndertimit i propozojme keshillit bashkiak ndryshimin e afatit të vendimit nr 13 datë 25.02.2022 nga 9-të (nëntë) vjekar në 10-të (ndhjetë) Vjekar duke mos ndryshuar siperfaqen ,vleren dhe funksionin .**

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e vendimit.

**Specialistet**

**Ing.Mark Suli**

**Ing.Zeqir Ujka**

**Miratoi**

**Drejtori**

**Rrok Ftoni**